



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT TË SHTETIT**

Adresa: Abdi Toptani, nr.1, Tiranë; Tel-Fax: 04-228485

webs-site: www.klsh.org.al

Nr.      Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ 2019

**PROJEKT**

**V E N D I M**

Nr. \_\_\_\_, Datë \_\_/\_\_/2019

**PËR**

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË 8 SUBJEKTE  
“PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË  
EVADUARA NË VITIN 2018”.**

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, gjatë auditimeve të evaduara në katërmujorin e parë të vitit 2017 dhe gjatë vitit 2018, sipas Programeve të Auditimit, si dhe në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Kryetarit nr.1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit” rezultoi se, nga **(220)** rekomandime të lëna gjithsej, nga të cilat janë rekomanduar **7** masa për përmirësime ligjore, janë rekomanduar **135** masa organizative, **17** masa zhdëmtim dëmi, me vlerën 304,406 mijë lekë, **32** masa për eliminimin e efekteve negative, **27** masa disiplinore si dhe janë rekomanduar **2** masa administrative, niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Në **8** subjekte të audituar, janë rekomanduar gjithsej **(220)** masa, nga të cilat janë pranuar **(174)** masa dhe nuk janë pranuar **46** masa. Konstatuam se nga 174 masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht **50** prej tyre, ose 28.7%, pjesërisht **15** masa, ose 8.7%, dhe konsiderohen në proces zbatimi **59** masa, ose 33.9%, dhe pa zbatuar **50** masa, të cilat përfaqësojnë 28.7%. Analiza sipas llojit të rekomandimeve të dhëna paraqitet:

**A. Masa për përmirësime ligjore** janë rekomanduar **7** nga të cilat janë pranuar **3** masa. Rezulton se nga masat e pranuar janë në proces zbatimi **3** rekomandime.

**B. Masa organizative** janë rekomanduar **135**, nga të cilat janë pranuar 108 masa, ose 80% e tyre, të pa pranuar 27 masa. Nga masat e pranuar, janë zbatuar **33** rekomandime, zbatuar pjesërisht **15** rekomandime, kanë nisur procedurat për zbatim **40** rekomandimeve dhe nuk janë zbatuar 20 rekomandime.

**C. Masa zhdëmtimi** janë rekomanduar **17**, për vlerën 304,406 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar **14** masa në vlerën 274,868 mijë lekë dhe nuk janë pranuar **3** masa. Nga masat e pranuar, janë zbatuar **5** rekomandime në shumën 28,204 mijë lekë, në proces zbatimi **3** rekomandime për vlerën 29,679 mijë lekë dhe nuk janë zbatuar 6 rekomandime, për vlerën 216,985 mijë lekë.

**D. Masa për eliminimin e efekteve** negative në fondet publike, janë rekomanduar **32** masa, nga të cilat janë pranuar **27** masa. Nga masat e pranuar, janë zbatuar **10** masa, janë në proces **13** rekomandime e nuk janë zbatuar 4 rekomandime.

**E. Masa administrative** janë rekomanduar **2 masa**, të cilat nuk janë pranuar.

**F. Masa disiplinore** janë rekomanduar **27**, janë pranuar **22 masa**, **nuk janë pranuar 5** masa disiplinore. Nga masat disiplinore të rekomanduara janë zbatuar plotësisht **2** masë, dhe nuk janë zbatuar 20 prej tyre.

Në përputhje me kërkesat e nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, 4 subjekte të audituara kanë kthyer përgjigje brenda 20 ditëve në KLSH, mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportet përfundimtare të auditimit nga KLSH, sipas afateve të përcaktuara dhe 4 subjekte nuk kanë kthyer përgjigje në afat. Gjithashtu konstatohet se, 3 subjekte nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Bazuar në këto rezultate të lidhura me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Sigurimit të Cilësisë dhe vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

## V E N D O S A:

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme për 4-mujorin e I të vitit 2017 dhe gjatë vitit 2018”, të ushtruar në 8 subjektet e audituara si dhe **të rikërkoj** zbatimin e rekomandimeve të lëna sipas auditimeve specifike si më poshtë vijon

### **1. NGA AUDITIMI NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2018**

**Gjetje nga auditimi:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit shkresën nr. 8339, datë 07.05.2019, me subjekt “Raportim mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në disa prej auditimeve të ushtruara gjatë vitit 2018, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë”, ku raportohet në lidhje me ecurinë e punës së bërë nga ana e MFE për zbatimin e rekomandimeve të papranuara, të pranuar plotësisht apo pjesërisht. Nga auditimi i dokumentacionit në dispozicion, rezulton se, nga 29 rekomandime të lëna nga KLSH situata paraqitet si më poshtë:

**a.** Masa Organizative, janë lënë 17 rekomandime nga të cilat: janë pranuar 4 rekomandime, janë pranuar pjesërisht 4 rekomandime, **nuk janë pranuar 7 rekomandime dhe nuk janë shprehur për 2 rekomandime;**

- b. Masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike, përfshi shpenzime të realizuar në kushte të paligjshmërisë procedurale nga **10** rekomandime të lëna: janë pranuar pjesërisht **6** rekomandime, **nuk janë pranuar 4 rekomandime;**
- c. Masa Administrative, është lënë **1** rekomandim, ku KLSH i rekomandon Nëpunësit të Parë Autorizues marrjen e masave në përputhje me kërkesat e nenit 51 "Menaxhimi i Angazhimeve" dhe nenit 71 "Kundërvajtjet administrative" të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duke analizuar rast pas rasti gjetjet, të reflektuara më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit, **i cili nuk është pranuar;**
- d. Masa Disiplinore, është lënë **1** rekomandim, ku KLSH i rekomandon Titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe Komisionit Disiplinor përkatës për vlerësim dhe dhënie masash disiplinore nga "Vërejtje" deri në "Largim nga puna" sipas përgjegjësisë individuale të drejtuesve konkret, **i cili nuk është pranuar.**

Duke qënë se rekomandimet e lëna në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në vetvete kanë për qëllim mirëqeverisjen dhe forcimin e përgjegjshmërisë në menaxhimin e financave publike me Vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 121, datë 09.10.2019, KLSH ka kërkuar që Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të marrë masat e nevojshme me qëllim realizimin e rekomandimeve të pranuar.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## **2. NGA AUDITIMI NË DREJTORINË E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK**

**Gjetje nga auditimi:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit shkresën nr. 16755/2 prot., datë 31.01.2019, ku raportohet në lidhje me ecurinë e punës së bërë nga ana e MFE për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Nga auditimi i dokumentacionit në dispozicion, rezulton se, nga 28 rekomandime të lëna nga KLSH situata paraqitet si më poshtë:

- a. Masa për ndryshime dhe përmirësime ligjore, janë rekomanduar **2** propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi, **të cilat nuk janë pranuar;**
- b. Masa Organizative, janë lënë **25 masa organizative**, nga të cilat **12 rekomandime nuk janë pranuar**, **1** masë është pranuar pjesërisht dhe janë pranuar **12** masa, nga të cilat janë në proces zbatimi **4** masa organizative, **1** masë e zbatuar pjesërisht dhe **7** masa janë zbatuar;
- c. Masa Disiplinore, është lënë **1** masë disiplinore, **i cila nuk është pranuar.**

Në Vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 123, datë 10.10.2019, KLSH ka kërkuar që Ministria e Financave dhe Ekonomisë të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH në auditimin e mëparshëm, dërguar nga KLSH me shkresën 301/8 prot., datë 07.08.2018, respektivisht: a) Për zbatimin e 2 propozimeve për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi, të cilat nuk janë pranuar. b) Për zbatimin e plotë edhe të 12 rekomandimeve për masa organizative të cilat nuk janë pranuar dhe 4 masa në proces zbatimi.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

### 3. NGA AUDITIMI NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË THESARIT

**Gjetje nga auditimi:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit shkresën nr. 8339, datë 07.05.2019, me subjekt “Raportim mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në disa prej auditimeve të ushtruara gjatë vitit 2018, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë”, ku raportohet në lidhje me ecurinë e punës së bërë nga ana e MFE për zbatimin e rekomandimeve të papranuara, të pranuar plotësisht apo pjesërisht. Nga auditimi i dokumentacionit në dispozicion, rezulton se, nga 10 rekomandime të lëna nga KLSH situata paraqitet si më poshtë:

- a. Masa për ndryshime dhe përmirësime ligjore, është lënë **1** rekomandim, **i cili nuk është pranuar**;
- b. Masa Organizative, janë lënë **4** rekomandime, nga të cilat janë pranuar **3** rekomandime dhe nuk është pranuar **1** rekomandim, ku **3** rekomandimet e pranuar nuk janë zbatuar;
- c. Masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike, përfshi shpenzime të realizuar në kushte të paligjshmërisë procedurale, janë lënë **3** rekomandime të pranuar nga subjekti, nga të cilat **1** rekomandim është në proces zbatimi dhe **2** rekomandime janë të pazbatuar;
- d. Masa Administrative, rekomanduar **1** masë, ku KLSH i rekomandon Titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe Komisionit Disiplinor përkatës për vlerësim dhe dhënie masash disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna” sipas përgjegjësisë individuale të drejtuesve konkret, e cila **nuk është pranuar**.
- e. Masa Disiplinore, janë lënë **2** rekomandime, ku KLSH në një rast është shprehur në mënyrë nominative, si dhe i rekomandon Titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe Komisionit Disiplinor përkatës për vlerësim dhe dhënie masash disiplinore nga “Vërejtje”, “Ulje në detyrë” deri në “Largim nga puna” sipas përgjegjësisë individuale të drejtuesve konkret, të cilat **nuk janë pranuar**.

Problematikat e konstatuara në DPTH vijojnë të ekzistojnë duke mos u marrë masat e duhura për përmirësimin e situatës, duke sjellë një impakt negativ në disiplinën buxhetore dhe për këtë arsye me **Vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 120, datë 08.10.2019, KLSH ka kërkuar** që nisur nga niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve si dhe ekzistenca e të njëjta problematikave sistematike në thyerje të sistemeve të kontrollit të disiplinës buxhetore dhe fiskale, zbatimin e rekomandimeve që rezultojnë të papranuara si dhe të atyre të pranuar por të pazbatuara.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

### 4. NGA AUDITIMI NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

**Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka dërguar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit shkresën nr. 4540/62, datë 23.05.2019, me subjekt “Raportim lidhur me zbatimin e Rekomandimeve sipas Raportit Përfundimtar”, në të cilën ka shprehur kundërshtimet e saj për rekomandimet e lëna, kryesisht për një rekomandim për përmirësim ligjor dhe një rekomandim për eliminimin e efekteve negative, që ka të bëjë me transferimin e borxhit të akcizës në DPD, si dhe ecurinë e zbatimit të rekomandimeve. Nga auditimi i dokumentacionit në dispozicion, rezulton se, nga 23 rekomandime të lëna nga KLSH situata paraqitet si më poshtë:

- a. Masa për ndryshime dhe përmirësime ligjore, janë lënë **3** rekomandime, **nga të cilat 1 rekomandim nuk është pranuar** dhe **2** rekomandimet e pranuar janë në proces zbatimi;

- b. Masa Organizative, janë lënë **10** masa organizative, nga të cilat **1** rekomandim nuk është pranuar, **1** është pranuar pjesërisht dhe për rekomandimet e pranuara rezultojnë: **3** rekomandime janë zbatuar dhe **6** rekomandime janë në proces zbatimi;
- c. Masa për shpërblim dëmi rekomanduar **1** masë, në shumën 79,596 lekë, e cila është arkëtuar nga subjekti përkatës, pra rekomandimi rezultoi i zbatuar;
- d. Masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike, përfshi shpenzime të realizuar në kushte të paligjshmërisë procedurale janë lënë **6** rekomandime, nga të cilat **1** rekomandim, i cili ka të bëjë me regjistrimin në kontabilitetin e DPT dhe më pas transferimin e borxhit të akcizës megjithëse nuk është pranuar nga DPT, referuar urdhërit të MFE është vijuar procedura e transferimit gjatë vitit 2019, tashmë dhe me një rritje prej 1 miliard lekë, pra konstatimi i KLSH-së në auditimin e mëparshëm ka qenë i saktë dhe i mbështetur ligjërisht, **1** rekomandim është pranuar pjesërisht, nga auditimi rezultoi se **1** rekomandim është zbatuar dhe **4** rekomandimet e pranuara janë në proces zbatimi;
- e. Masa Disiplinore, janë rekomanduar **3** masa, nga të cilat është dhënë **1** masë disiplinore dhe është pushuar ecuria disiplinore për **2** masat e tjera.

Sa më sipër, me Vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 119, datë 08.10.2019, KLSH ka rekomanduar që Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të analizojnë rekomandimet e pa realizuara, duke marrë masa të menjëhershme për nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjësive konkrete ligjore për moszbatimin e tyre, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 280/12prot., datë 21.11.2018

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## 5. NGA AUDITIMI NË INSTITUTIN E SIGURIMEVE SHOQËRORE

**Gjetje nga auditimi:** Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka dërguar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit shkresën nr. 72/5, datë 23.01.2019, me subjekt “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i aktivitetit ekonomiko-financiar për vitin 2017”, ku raportohet në lidhje me ecurinë e punës së bërë për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Nga auditimi i dokumentacionit në dispozicion, rezultoi se, nga 26 rekomandime të lëna nga KLSH situata paraqitet si më poshtë:

- a. Masa Organizative, janë lënë **25** rekomandime, të pranuara plotësisht nga subjekti, nga të cilat janë zbatuar **11** rekomandime, janë zbatuar pjesërisht **5** rekomandime dhe janë në proces zbatimi **3** rekomandime dhe nuk janë zbatuar **6** rekomandime;
- b. Masa Disiplinore, është lënë **1** rekomandim, ku KLSH i kërkon Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH, analizimin e shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Vendimin nr. 65, datë 28.06.2018 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe ngritjen e Komisionit të Disiplinës për fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara, nëpunësve përgjegjës. dhe zbatuar nga subjekti, rekomandim i cili nuk është zbatuar.

Sa më sipër, me Vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 55, datë 22.08.2019, KLSH ka rekomanduar që strukturat drejtuese të ISSH, të marrin masa të përcaktojnë personat përgjegjës dhe

analizojnë nivelin e zbatimit të rekomandimeve, me qëllim zbatimin e plotë të rekomandimeve në process dhe atyre të pa zbatuara, me qëllim përmirësimin e punës, brenda vitit 2019.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## **6. NGA AUDITIMI NË FONDIN E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR**

**Gjetje nga auditimi:** Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor ka dërguar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit shkresën nr. 1225/1prot., datë 09.04.2019, me subjekt “Për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ku raportohet në lidhje me ecurinë e punës së bërë nga ana e FSDKSH për zbatimin e rekomandimeve të pranuar plotësisht apo pjesërisht. Nga auditimi i dokumentacionit në dispozicion, rezulton se, nga 39 rekomandime të lëna nga KLSH situata paraqitet si më poshtë:

- c. Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi, është lënë **1** rekomandim, i cili është pranuar dhe është në proces zbatimi;
- d. Masa Organizative, janë lënë **21** rekomandime nga të cilat: janë pranuar **21** rekomandime, nga të cilat janë zbatuar **6** rekomandime, janë zbatuar pjesërisht **2** rekomandime dhe janë në proces zbatimi **13** rekomandime;
- e. Masa për shpërblim dëmi, janë lënë **4** rekomandime të cilat janë pranuar, nga të cilat janë në proces zbatimi **2** rekomandime dhe janë pazbatuar **2** rekomandime;
- f. Masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike, përfshi shpenzime të realizuar në kushte të paligjshmërisë procedurale, nga **12** rekomandime të lëna: janë pranuar **12** rekomandime, nga të cilat janë zbatuar 3 rekomandime, janë në proces zbatimi **8** rekomandime dhe pa zbatuar 1 rekomandim;
- g. Masa Disiplinore, është lënë **1** rekomandim, i cili është pranuar dhe zbatuar nga subjekti.

Sa më sipër, me Vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 77, datë 18.09.2019, KLSH ka rekomanduar që nga Këshilli i Administrimit i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor të analizohet dhe nxirret përgjegjësia administrative për mos marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, të cilat kanë sjellë përkeqësim të situatës financiare të institucionit dhe rritje të shpenzimeve buxhetore në skemën e rimbursimit të barnave, manaxhimit të shërbimeve nën kontratat koncesionare të partneritetit publik privat, të krijimit të detyrimeve të prapambetura etj.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## **7. NGA AUDITIMI NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE**

**Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka dërguar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit shkresën nr. 8559 prot, datë 04.04.2019, me subjekt “Dërgim të relacionit të grupit të punës mbi RPA ardhur sipas shkresës nr. 22995/11 prot dt 08/10/2018”, ku informon në mënyrë të detajuar lidhur me zbatimin e rekomandimeve. Nga auditimi i dokumentacionit në dispozicion, rezulton se, nga 48 rekomandime të lëna nga KLSH situata paraqitet si më poshtë:

- a. Masa Organizative, janë lënë **24** rekomandime nga të cilat: janë pranuar **21** rekomandime, nga të cilat nga të cilat është zbatuar plotësisht **1** rekomandim, janë zbatuar pjesërisht **3** rekomandime, janë në proces zbatimi **14** rekomandime, nuk janë zbatuar **6** rekomandime dhe nuk janë pranuar **3** rekomandime;
- b. Masa për shpërblim dëmi, nga 7 rekomandime të lëna, janë pranuar **4** rekomandime, të cilat janë pazbatuara;
- c. Masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike, përfshi shpenzime të realizuar në kushte të paligjshmërisë procedurale, është lënë 1 rekomandim i është i pazbatuar;
- d. Masa Disiplinore, janë lënë **16** rekomandime, të cilat nuk janë zbatuar nga subjekti.

Sa më sipër, me Vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 118, datë 07.10.2019, KLSH ka rekomanduar që Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në cilësinë e organit epror dhe Degët Doganore në cilësinë e “autoritetit doganor kompetent” të analizojnë në bashkëpunim të plotë rekomandimet e përcaktuara, duke marrë masa të menjëhershme për analizimin e shkaqeve dhe përgjegjësi konkrete ligjore për moszbatimin e tyre. Nga këto institucione të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme verifikuese dhe administrative ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për kontabilizimin e shumës prej **105,142 mijë lekë**, rekomanduar më parë në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe anekseve përkatëse, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 280/11prot., datë 05.10.2018 dhe protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me shkresën nr. 22995prot., datë 08.10.2018.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## 8. NGA AUDITIMI NË DEGËN DOGANORE ELBASAN

**Gjetje nga auditimi:** Dega Doganore Elbasan me shkresën nr. 348prot., datë 11.05.2017 ka paraqitur “Planin e veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH”. Nga auditimi i dokumentacionit në dispozicion, rezulton se, nga 15 rekomandime të lëna nga KLSH situata paraqitet si më poshtë:

- a. Masa Organizative, janë lënë **6** rekomandime, të pranuar plotësisht, nga të cilat janë zbatuar plotësisht **5** rekomandime dhe është në proces zbatimi **1** rekomandim;
- b. Masa për shpërblim dëmi, nga 5 rekomandime të lëna e të pranuar, janë zbatuar plotësisht **4** rekomandime dhe është në proces zbatimi **1** rekomandim;
- c. Masa Disiplinore, janë lënë **4** rekomandime, të cilat janë pranuar e zbatuar nga subjekti.

Sa më sipër, me Vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 105, datë 30.09.2019, KLSH ka rekomanduar që Dega Doganore Elbasan, në cilësinë e organit administrativ të juridiksionit të analizojë rekomandimet e pazbatuara, si dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme verifikuese, administrative dhe gjyqësore për **1 masë** organizative si dhe për verifikimin, vendimmartjen dhe kontabilizimin e shumës së dëmit ekonomik prej **6,001 mijë lekë** rekomanduar më parë në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe anekseve përkatëse, përcjellë me shkresën nr. 1229/11 prot, datë 30.04.2017 dhe shkresën nr. 1602/6, datë 05.02.2018.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## **II. Të tjera.**

*Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi apo të zbatuara pjesërisht të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Zbatimit të Rekomandimeve, të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda 6-mujorit të parë të vitit 2020.*

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.*

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**